

NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR PËR LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE

Në zbatim të Nenit 26, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të pikës 13 të Kreut II dhe III të Vendimit Nr.242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, Bashkia Elbasan, në përfundim të verifikimit përfundimtar të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të posaçme të përcaktuara në shpalljet për konkurim njofton se për pozicionet:

- *Përgjegjës, Sektori Azhornimit Topografik në Drejtorinë e Projektimit dhe Azhornimit Topografik – Kategoria III A/1*
- *Përgjegjës, Sektori Arsimit Parashkollor në Drejtorinë e Politikave të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit – Kategoria III A/1*
- *Përgjegjës Sektori Ligjshmërisë së Akteve dhe Hartimit të Kontratave Drejtorinë Juridike, – Kategoria III A/1*

Nuk ka kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit.

Duke filluar nga data **11.07.2022**, do të njoftohen nëpërmjet faqes së Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan , të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë ose pranim në shërbimin civil , në lidhje me datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurimi.